



217 | 2  
17.02.20

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
DREJTORIA LIGJORE DHE TEKNIKE  
SEKTORI TEKNIK

Nr. 939/1 Prot.

Tiranë, më 16/2 /2020

Lënda: Kthim përgjigje

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE ✓

Adresa: "Rruga e Kavajës", Nr.1001, Tiranë

Për dajeni: **MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr.3, Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj, Nr.217 Prot, datë 15.01.2020, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me Nr.939, datë 17.01.2020, sqarojmë si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, lidhur me aplikimin e TVSH-së për shoqëritë konçesionare "3PLife Logistik" dhe Sani Service", është referuar kuadrit ligjor në fuqi si vijon:

Ligji Nr.92/2014, datë 27.07.2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 2 "Fusha e zbatimit", dhe Udhëzimi Nr.6 datë 30.01.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, konkretisht, neni 38 "Furnizimet e barnave dhe shërbimeve shëndetësore", paragrafi II, "Shtirirja e përjashtimit të TVSH-së", ku përcaktohet se, furnizimi i shërbimeve shëndetësore ndaj pacientit ku përfshihen të gjitha shërbimet për parandalimin, diagnozën, trajtimin, kurimin e sëmundjes apo çrregullimeve shëndetësore dhe rehabilitimin, të ofruara nga institucionet shëndetësore publike ose private të njohura ose të licencuara nga autoritetet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

Në kuptim të kësaj dispozite "veprimet e lidhura me shërbimet shëndetësore" janë veprimet e domosdoshme që furnizohen (kryhen) nga vetë institucioni shëndetësor, për ofrimin e shërbimit shëndetësor dhe si pjesë e tij.

Është kusht që këto shërbime dhe veprime të trajtohen si shërbime të përjashtuara nga TVSH, duhet të ofrohen (furnizohen) nga institucionet shëndetësore publike ose private, ose në kuadër të ushtrimit të profesionit mjekësor ose paramjekësor, të njohur dhe licencuar si të tillë nga autoriteti kompetent shëndetësor.

Gjithashtu, ky udhëzim ka përcaktuar se, citojmë: "Parimi i përjashtimit në rastin e shërbimeve shëndetësore është që shërbimi shëndetësor i cili është kryesori dhe shërbimi anësor (aksesor) bëhen nga i njëjti person i tatueshëm, në këtë rast, institucion shëndetësor.

Në përfundim, referuar përcaktimeve të mësipërme Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka mbajtur qëndrimin se furnizimi shërbimit i kryer nga koncesionari është furnizim i tatueshëm me TVSH.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Delina Ibrahimaj**

